



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 06 qershor 2019
Nr. ref.: RK 1369/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI168/18

Parashtrues

Gazmend Jakupi

**Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme PML. nr. 152/2018, të 16 korrikut 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Gazmend Jakupi nga Gjilani (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme PML. nr. 152/2018, të 16 korrikut 2018, me të cilin ishte refuzuar kërkesa e tij për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit PN. nr. 145/2018, të 21 shkurtit 2018.
3. Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme iu dorëzua parashtruesit të kërkesës më 13 gusht 2018.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme PML. nr. 152/2018, me të cilin pretendohet se parashtruesit i janë shkelur të drejtat themelore kushtetuese të garantuara me nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe të drejtat e garantuara me nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt), të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 29 tetor 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 5 nëntor 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.
8. Më 13 nëntor 2018, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 14 maj 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 1 korrik 2014, parashtruesi i kërkesës sulmoi fizikisht personin G.Q., me ç'rast atij i shkaktoi lëndime trupore.
11. Më 17 korrik 2014, Prokuroria Themelore- Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan (në tekstin e mëtejme: Prokuroria) ngriti aktakuzën PP. I. nr.

157/2014, kundër parashtresit të kërkesës, për shkak të dyshimit të bazuar se ai ka kryer disa vepra penale, dhe atë „*lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 nen par. 1. 1 të KPRK-ës, dhe përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK-ës.*“

12. Më 4 dhjetor 2014, Departamenti për Krime të Rënda i Gjykatës Themelore në Gjiilan (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore), mbajti një seancë publike për marrëveshjen e pranimin të fajit dhe sanksionin penal, ku morën pjesë prokurori, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij.
13. Gjatë seancës gjyqësore të Gjykatës Themelore, u arrit marrëveshja për pranimin e fajësisë.
14. Po të njëjtën ditë, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin PKR. nr. 155/14, me të cilin parashtresi i kërkesës u shpall fajtor në bazë të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, për kryerjen e veprave penale për të cilat ishte akuzuar, dhe e dënoi me dënim unik me burg prej shtatë (7) muajsh, në të cilin ishte llogaritur koha e kaluar në paraburgim, si dhe i'u shqiptua gjoba në shumën prej 300 €.
15. Në arsyetimin e aktgjykimit, Gjykata Themelore deklaroi: *“Gjykata është e bindur se i akuzuari i ka kryer veprat penale që i vihen në barrë. Në seancën e marrëveshjes së pranimin të fajësisë përfaqësuesi i akuzës, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij janë pajtues me dënimet”.*
16. Më 6 dhjetor 2017, përfaqësuesi i parashtresit të kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën Themelore për rishikimin e procedurës penale, në të cilën kishte theksuar: *“pasi që aktgjykimi ka marrë formën e prerë mbrojtja ka mësuar se ka fakte dhe prova të reja të cilat vetë ose së bashku me provat e mëhershme kanë të ngjarë të arsyetojnë se i gjykuari në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i pa përgjegjshëm.”*
17. Më 28 dhjetor 2017, Prokuroria në shkresën PP. nr. 157/2017, dha përgjigje se kërkesa e të dënuarit për rishikimin e procedurës penale është refuzuar, sepse nga përmbajtja e kërkesës dhe shkresave në fjalë shihet se kushtet e parashikuara në nenin 423 paragrafi 1 nënparagrafët 1. 1, 1. 2, 1. 4 dhe 1.5 të KPP-së nuk janë përmbushur.
18. Më 30 janar 2018, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin PKR. nr. 155/2014, me të cilin është refuzuar kërkesa për rishikimin e procedurës penale të parashtresit të kërkesës. Në arsyetimin e Aktvendimit Gjykata Themelore deklaroi:

„Kolegji kërkesën e të dënuarit për rishikimin e procedurës penale e refuzoi si të pa bazuar, për arsye se nuk ekzistojnë asnjë nga arsyet ligjore, për rishikimin e procedurës penale të parapara në nenin 423 paragrafi 1 të KPP-së, meqenëse nga i dënuari nuk është paraqitur ndonjë dëshmi apo provë konkrete e cila do të arsyetonte pafajësinë e tij. Poashtu në rastin konkret nuk qëndrojnë as pretendimet ankimore të mbrojtësit të të dënuarit se i gjykuari në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i pa përgjegjshëm, ngase me të gjitha provat është vërtetuar se i njëjti është

kryes i veprave penale për të cilat është shpallur fajtor, për çka edhe vetë i dënuari e ka pranuar fajësinë dhe ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë për këto vepra penale, e që në këtë rast e bëjnë aktgjykimin e drejtë dhe në përputhje me dispozitat ligjore.“

19. Më 9 shkurt 2018, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit ndaj Aktvendimit të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe të lejojë rishikimin e procedurës penale.
20. Më 21 shkurt 2018, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin PN. nr. 145/2018, me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar ankesa e parashtruesit të kërkesës, duke theksuar:

„Rishikimi i procedurës penale të përfunduar me aktvendim të formës së prerë mund të lejohet nëse zbulohen fakte të reja ose paraqiten prova të reja, të cilat vetë ose së bashku me provat e mëparshme ka të ngjarë të arsyetojnë pafajësinë e personit të dënuar ose dënimin e tij sipas një dispozite më të butë penale.

Pretendimet se i gjykuari në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i pa papërgjegjshëm, janë të pa bazuara sepse faktet dhe provat të cilat i njëjti i ka prezantuar gjykatës nuk janë prova bindëse të cilat do të arsyetonin paaftësinë mendore të gjykuarit.

Po ashtu, duke pasur parasysh faktin se i gjykuari ka pasur të njëjtin mbrojtës prej fillimit të procedurës penale e deri te paraqitja e kërkesës për rishikim të procedurës penale, i cili ka mundur ta udhëzojë të gjykuarin që të mos e pranojë fajësinë para shpalljes së aktgjyimit, e jo pasi që i njëjti e ka pranuar fajësinë dhe ka arritur marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.“

21. Më 30 maj 2018, parashtruesi, kundër aktgjyimit të Gjykatës së Apelit parashtroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.
22. Më 16 korrik 2018, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin PML. nr. 152/2018, me të cilin kërkesa e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë, ishte refuzuar si e pabazuar. Në aktgjykimin e saj, Gjykata Supreme theksoi:

„Duhet të theksohet se në këtë çështje penale i dënuari ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë për veprat penale për të cilat është akuzuar dhe ky pranim i fajësisë është bërë në bazë të rregullave të procedurës penale respektivisht konform nenit 233 të KPPK-së dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat të cilat përjashtojnë përgjegjësinë penale të parapara sipas nenit 253 par.1 të KPPK-së. Pra që në fillim i dënuari ka pasur mbrojtje dhe me këshillat e mbrojtësit të tij ka pranuar fajësinë. Qëndron fakti se i dënuari ka pasur të shqiptuar masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri për një vepër penale të kryer para se të ndodhë ngjarja kritike më 1.7.2014, por kjo nuk do të thotë se i dënuari ka pasur probleme psikike të vazhdueshme [...].

Askund në këtë raport nuk ceket se i dënuari ka vuajtur nga ndonjë sëmundje psikike apo çrregullim psikik, qoftë momental apo të përhershëm, në momentin e kryerjes së veprës penale.“

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Në kërkesën e tij, parashtruesi para së gjithash pretendon se në momentin e kryerjes së veprës penale për të cilën është dënuar me aktgjykim të formës së prerë të Gjykatës Themelore, *“ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore.“*
24. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendon se duke iu nënshtruar një procedure hetimore dhe gjyqësore në një gjendje psikike të tillë të aftësisë së kufizuar mendore ose aftësi mendore të reduktuar në masë të madhe, ai personalisht dhe drejtpërdrejt u bë viktimë e shkeljes së të drejtave të garantuara me Kushtetutë nga autoritetet publike - gjykatat e Republikës së Kosovës.
25. Parashtruesi konsideron se në këto procedura gjykatat kanë shkelur të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
26. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që të konstatojë se gjykatat e rregullta i kanë shkelur të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

27. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe më tej të parapara në Ligj dhe të specifikuara në Rregullore të punës.
28. Në këtë drejtim, Gjykata i'u referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

„1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.“

29. Gjykata gjithashtu vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata u referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49 [Afatet]

„Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

30. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e ka dorëzuar kërkesën në cilësinë e palës së autorizuar duke e kontestuar aktin e autoritetit publik, pas shtrirjes së të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesi i kërkesës i ka theksuar gjithashtu edhe të drejtat që pretendon se i janë cenuar në pajtim me kushtet e theksuara në nenin 48 të Ligjit si dhe e ka dorëzuar kërkesën në afat të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
31. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë], paragrafi (3) (b) të Rregullores së punës, i cili parashikon:
- “(3) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse janë të pranishme ndonjë nga kushtet në vijim:
[...]
(b) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën;
[...].”*
32. Gjykata, duke analizuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, së pari vëren se parashtruesi i kërkesës në seancën e Gjykatës Themelore të mbajtur më 4 dhjetor 2014, në të cilën morën pjesë prokurori dhe avokati i tij mbrojtës, nënshkroi marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, në bazë të së cilës ai ishte dënuar me një aktgjykim të formës së prerë P. KR. nr. 155/14 të Gjykatës Themelore.
33. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi i kërkesës më 6 dhjetor 2017 parashtroi në Gjykatën Themelore *„Kërkesë për rishikim të procedurës”*, e cila u refuzua me vendimet e gjykatave të rregullta si e pabazuar.
34. Në këtë drejtim, Gjykata në rastin konkret konkludon se parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta duke vendosur për kërkesën e tij për rishikimin e procedurës penale, kanë shkelur të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.
35. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta e refuzuan kërkesën e tij për rishikimin e procedurës penale, me ç'rast nuk kishin marrë parasysh faktin se në momentin e kryerjes së veprës penale për të cilën ai u dënua në vitin 2014 me Aktgjykim të formës së prerë P. KR. nr. 155/14, nga Gjykata Themelore, *”ai në të vërtetë, për shkak të gjendjes së tij mendore ishte i paqftë për gjykim”*.

36. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta, lidhur me kërkesën e parashtruesit për rishikimin e procedurës penale, kishin vendosur ekskluzivisht lidhur me përmbushjen e kushteve procedurale për rishikimin e procedurës penale dhe jo për meritat e çështjes.
37. Gjykata rithekson se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës: *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”*
38. Duke pasur parasysh pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe të cilat ai i sjell vetëm në lidhje me kërkesën për rishikimin e procedurës penale, Gjykata rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, dhe praktikën e saj gjyqësore, sipas së cilës neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së nuk zbatohen në kërkesat për rishikimin ose përsëritjen e procedurës (shih: në mënyrë analoge rastet e Gjykatës Kushtetuese: KIO7/17/15, *Pashk Mirashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 qershorit 2017, paragrafi 64; KI80/15, 81/15 dhe 82/15, *Rrahim Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 dhjetorit 2016, paragrafi 31; KI 76/18, Pjetër Boçi, Aktvendim për papranueshmëri 14 dhjetor 2018. Po ashtu, shih rastet e GJEDNJ-së, *inter alia*, *Oberschlick kundër Austrisë*, nr. 23727/94, vendim për papranueshmëri i 21 marsit 1994 *Dowsett kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 8559/08, vendim për papranueshmëri i 4 janarit 2011, *Sablon kundër Belgjikës*, nr. 36445/97, Aktgjykim i 10 prillit 2001, paragrafi 86).
39. Për më tepër, Gjykata rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së e cila konstaton se neni 6 nuk zbatohet në procedurat për rishikimin e ndonjë rasti sepse një person dënim i të cilit është bërë i plotfuqishëm dhe i cili bën kërkesë për rishikimin e rastit të tij nuk është *“akuzuar për vepër penale”* brenda kuptimit të nenit 6 (shih rastet e GJEDNJ *Franz Fischer kundër Austrisë*, nr. 27569/02, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 majit 2003).
40. Në pajtim me këtë, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit lidhur me refuzimin nga gjykatat e rregullta për të rishikuar procedurën penale nuk janë *ratione materiae* në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
41. Prandaj, kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 39 (3) (b) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 47 të Ligjit dhe të rregullit 39 (3) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 14 maj 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi



Kryetarija e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi